



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.


KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.o.o.

I Nr. 98 Dt. 10/06/2014

Për: z. Enver Halimi
Kryesues i Bordit të Zyrës së
Rregullatorit për Energji
Rruga "Dervish Rozhaja" nr.12
10000 Prishtinë

Nga: Arben Gjokaj
Drejtor Menaxhues
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.
Sheshi Nënë Tereza nr.36
Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

Datë: 09.06.2014



Nr. 3009/14
Data 11.06.14

Lënda: Kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm

I nderuar z. Halimi,

Me datën 06 qershor 2014, pas orës 10:00 ka ndodhur një shpërthim në repartin e elektrolizës të Termocentralit Kosova A.

Menjëherë pas marrjes së këtij informacioni ekipet mbikëqyrëse të KEK-ut kanë dalë në vendin e ngjarjes. Ndërkohë që informacioni është shpërndarë në të gjitha institucionet relevante. Në vendin e ngjarjes kanë dalë të gjitha njësitë e autorizuar të Policisë së Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave nga niveli qendror, komunal dhe ekipet mjekësore të qendrave të mjekësisë së punës dhe ato të QKUK-së.

Si pjesë e planeve operative të reagimit emergjent, është vendosur të ndalen dy njësitë e TC Kosova A, që ishin aktualisht në prodhim, njësisia A3 dhe A5, ndërsa që në vendin e ngjarjes të gjitha ekipet e specializuara bashkërisht me shpejtësi kanë filluar evakuimin e personelit që në atë moment gjendej duke punuar në atë repart si dhe në repartet përreth, si dhe është bërë sigurimi i perimetrit të zonës ku ka ndodhur shpërthimi.

Si pasojë e rrethanave të krijuara, KEK-u kërkon nga ZRRE fillimin e procesit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm. Sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit, neni 6.1 "Shqyrtimet e jashtëzakonshme - Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme", dhe siç përkufizohen në Shtojcën 6, "procesi i shqyrtimit të jashtëzakonshëm", dhe shtojcën 7, "ngjarja e jashtëzakonshme", KEK-u kërkon që të bëhet shqyrtim i jashtëzakonshëm për shkak të ngjarjes së jashtëzakonshme të ndodhur sipas nenit 1.3 të shtojcës 7 të kësaj Rregulle.

KEK-u është në proces të vlerësimit të dëmëve të shkaktuara nga shpërthimi që ka ndodhur në repartin e elektrolizës të Termocentralit Kosova A dhe pas përgatitjes së raportit përfundimtar të

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e korporatizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës
Numri i Regjistrimit: 70325399

Zyra e regjistruar: Rr. Nënë Tereza Nr. 36, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

vierësimit të dëmëve të shkaktuara, KEK-u do të dërgojë në ZRRE raportin e ndikimit financiar sipas shtojcës 6 të Rregullës për përcaktimin e çmimit.

KEK-u konsideron se procesi i shqyrtimit të jashëzakonshëm dhe marrja në konsideratë e kostove të shkaktuara nga shpërthimi në repartin e elektrolizës është e domosdoshme për të mundësuar funksionim normal të KEK-ut.

Si gjithmonë, KEK-ut mbetet i hapur për çdo takim me ZRRE-në, në mënyrë që të diskutojë të gjitha çështjet që ndërlidhen me ngjarjen e jashtëzakonshme.

Me nderime,


Arben Gjukaj
Drejtor Menaxhues



Kopje:

Antarët e Bordit – ZRRE
Ymer Fejzullahu – udhëheqës i departamentit për tarifa e çmime
Rifat Blakaj – Udhëheqës i departamenti të tregut të energjisë
Antarët e Bordit – KEK